



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 77/2021 regjistër (JR)
Datë 13.12.2021

Nr. 25 vendimit
Datë 23.05.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol	Çomo	Kryesues
Ina	Rama	Relatore
Albana	Shtylla	Anëtare
Natasha	Mulaj	Anëtare
Mimoza	Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.05.2024, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 456, datë 08.10.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Neni F i Aneksit të Kushtetutës; Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62, 63 dhe 66; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet para seancës, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetime për 3 (tri) kriteret e vlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

2.1. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, i ka dërguar Komisionit raport kontrolli¹, në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Hoxha:*

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.10.2018.

një raport² për subjektin e rivlerësimit. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Hoxha: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Si konkluzion, Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Hoxha.

2.3. KLGj-ja ka hartuar raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilin ia ka përcjellë Komisionit³.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 456, datë 08.10.2021, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Irena Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...].*
4. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Hoxha, është marrë bazuar në përcaktimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në referim të konkluzione të mëposhtme që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë⁴, për të cilin ka konkluduar se: *Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha: i) ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016); ii) ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak të balancës negative në shumën 7.350.904 lekë (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016).*

²Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 13.09.2021, të KDZh-së.

³Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.09.2021.

⁴Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar sa vijon:

- Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

- Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; - subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; - subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016; - subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33 të këtij ligji, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 456, datë 08.10.2021, të Komisionit, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Hoxha, për shkaqe që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
6. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): (i) marrjen në cilësinë e provës të akteve të bashkëlidhura ankimit; (ii) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (iii) ndryshimin e vendimit nr. 456, datë 08.10.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

A. Shkaqet e ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregull ligjor

7. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi renditen si më poshtë.

7.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në shqyrtimin e çështjes së saj të rivlerësimit, ka kryer shkelje procedurale dhe të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat kanë të bëjnë me: (a) mosnjohimin subjektiv të rezultateve të pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës dhe me mosnjohimin për shkeljet që kishte kryer; (b) moszbatimin e ligjit lidhur me gjetjen e rezultateve paraprake të hetimit se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat nga bujqësia, duke pretenduar se legjislacioni i kohës nuk ka parashikuar pasjen/ekzistencën e ndonjë dokumentacionit lidhur me këto të ardhura; (c) moskonsiderimin nga Komisioni të akteve që ka paraqitur subjekti për të provuar të ardhurat nga bujqësia, megjithëse janë kërkuar prej tij; (ç) mosrespektimin e përcaktimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “ligji nr. 9887/2008”), pasi vendimi objekt gjykimi ka një sërë të dhënash personale, sensitive për kunatin dhe kunatën e subjektivit.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

8. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi renditen si më poshtë.

8.1. Konkluzioni i Komisionit se deklarimi i subjektivit është i pasaktë, pasi nuk përmbush kërkesa e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, është një qëndrim jo i drejtë dhe i pabazuar, pasi në deklaratën *vetting*, e cila është objekt kontrolli sipas ligjit nr. 84/2016, ka dhënë deklarime të sakta, të plota dhe të vërteta, për pasuritë e saj dhe të familjes.

8.2. Konkluzioni i Komisionit se huadhënësi P.H., për shumën e dhënë hua në masën 60.000 euro në vitin 2010, ka mungesë të burimeve të ligjshme është i gabuar dhe jo i bazuar në ligj, pasi:

- a) Shuma e dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është krijuar nga huadhënësi me burime të ligjshme të siguruara nga puna në emigracion dhe nga të ardhurat nga bujqësia.
- b) Metodologjia e aplikuar nga Komisioni për analizimin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, z. P.H., për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit, është e gabuar, jo në përputhje me situatën faktike, si dhe vjen në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.

8.3. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë periudhës së rivlerësimit është i gabuar dhe jo i bazuar në ligj, pasi në analizën financiare të kryer nga ky organ, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar gjithmonë me situatë financiare pozitive, duke konsideruar se momenti i vetëm, në të cilin subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar krijimin e pasurisë apartament në Tiranë, ka ardhur pasi nuk është përfshirë si burim financimi i kësaj pasurie shuma prej 60.000 eurosh, e siguruar nga huaja e marrë nga huadhënës P.H.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Hoxha, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankueses

- 10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

- 11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, kryhet në dhomë këshillimi. Me ankimin objekt gjykimi, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: *Shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike*,

duke pretenduar marrjen në cilësinë e provës aktet që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit. Për këtë qëllim, subjekti i ka bashkëlidhur ankimit, aktet: **(i)** leje qëndrimi e vitit 1998, në Greqi, e z. P.H., në gjuhën greke, e noterizuar me aktin “vërtetim i njësisë me origjinalin”, me nr. {***} rep., datë 24.11.2021 dhe të përkthyer me aktin “vërtetim përkthimi” me nr. {***} rep., datë 24.11.2021, të noteres E.A.; **(ii)** certifikatë e gjendjes familjare të familjes së z. P.H. e lëshuar më datë 21.11.2021, nr. {***}, nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë, e cila evidenton se: “Familja ardhur nga ZGjC Peshkopi më datë 04.09.2000”; **(iii)** aktin “Kthim përgjigje” të drejtuar ILDKPKI-së nga znj. Irena Hoxha, e cila ka shënimin *marrë në dorëzim nga zyra e protokollit të ILDKPKI-së, më datë 15.03.2012*; **(iv)** vërtetim me nr. {***} prot., datë 18.11.2021, të AShK-së Drejtoria Vendore Dibër.

11.1. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, lidhur me aktet bashkëlidhur ankimit, nuk ka dhënë shpjegime, në kuptim të përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012”), përse ato nuk janë paraqitur prej saj në Komision, ndonëse duke konsideruar entet publike që i kanë nxjerrë ato nuk evidentohen pengesa ligjore apo të arsyeshme për mosparaqitjen e tyre gjatë hetimit administrativ, duke e lënë në këtë mënyrë të paargumentuar pretendimin se në rastin e çështjes së saj të rivlerësimit, në kuptim të kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, Kolegji duhet të gjykojë çështjen në seancë gjyqësore publike në funksion të marrjes së provave të reja.

Gjithashtu, trupi gjykues, lidhur me përmbajtjen dhe informacionin që japin aktet bashkëlidhur ankimit, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, konstaton se ato nuk përmbajnë të dhëna apo fakte të reja në funksion të përcaktimit të gjendjes faktike të ndryshme nga ajo që ka vlerësuar Komisioni. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për të konsideruar këto akte me cilësinë e provës së re, vlerësohet si i pabazuar edhe në drejtim të ndikimit që ato mund të kishin në zgjidhjen e çështjes e, për pasojë, ato nuk mund të detyrojnë trupën gjyqësore të vendosë për marrjen e tyre nëpërmjet kalimit në seancë gjyqësore publike.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregull ligjor

12. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të adresuara ndaj shkeljeve, që sipas saj kanë cenuar procesin e rregullt ligjor, të cilat u analizuan si më poshtë.

12.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk e ka njoftuar për rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës, si edhe as për shkeljet që ajo kishte kryer, në kundërshtim me detyrimin për t’i kaluar barrë prove subjektit për çdo gjetje, e cila e ngarkon atë me përgjegjësi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” (në vijim ligji nr. 44/2015), dispozitë e cila detyron organin publik t’i bëjë prezent palës provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës.

12.2. Lidhur me pretendimin për mosnjohjen me çështjet për të cilat duhej të përgjigjej subjekti i rivlerësimit, nga analizimi i akteve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se Komisioni, me anë të tri pyetësorëve dhe të një kërkesë për informacion (që ka të bëjë me

personin tjetër të lidhur, z. P.H.), i ka kërkuar shpjegime subjektit për çështje të ndryshme që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, dhe se vetëm pasi subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me to, Komisioni ka vijuar me hartimin e raportit të rezultateve paraprake të hetimit administrativ, për të cilat ka ftuar subjektin të marrë kopje elektronike të akteve të fashikullit të hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni. Në këtë raport rezulton se Komisioni ka evidentuar në mënyrë të qartë çështjet për të cilat, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kalohet subjektit barra e provës, të cilat rezultojnë të jenë të njëjtat për të cilat Komisioni, me anë të pyetësorëve, i ka kërkuar më parë shpjegime. Gjithashtu në këtë akt, rezulton se kanë gjetur pasqyrim të gjitha çështjet që kanë ndikim në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke evidentuar konstatimet e Komisionit dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe vlerësimin paraprak të Komisionit lidhur me to. Në këtë raport rezulton se Komisioni⁵ ka evidentuar qartësisht përse është bërë analiza financiare, metodologjinë e aplikuar dhe rezultatin përfundimtar të saj, duke ftuar qartësisht subjektin të mbrohet për çështjet e parashtruara në të.

12.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me parashikimin e nenit 87 të ligjit nr. 44/2015, sepse nuk i ka bërë me dije rezultatet e pritshme të procedurës së rivlerësimit dhe motivimin përkatës, duke i pamundësuar mbrojtjen e duhur, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje të njëjtën situatë faktike si ajo e përshkruar më lart. Në raportin për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, në të cilin potencialisht subjekti duhej të gjejë rezultatin e pritshëm të procedurës hetimore, sipas kuptimit që ka neni 87 i ligjit nr. 44/2015, për aq sa është e mundur të zbatohet në procesin e rivlerësimit, ku janë të përcaktuara çështjet që ngrihen para subjektit, për të cilat kalohet barra e provës, që qartazi nënkupton se cili është prezumimi ligjor që zbatohet në rast se subjekti nuk arrin të përmbysë atë. Në të gjitha procedurat e rivlerësimit, Komisioni ka pasur kujdesin të bëjë të kuptueshëm rezultatin e hetimit nëpërmjet çështjeve që ngrihen dhe për të cilat kalohet barra e provës, dhe që duhet të marrin praktikisht të gjithë vëmendjen e subjektit në drejtim të ushtrimit të mbrojtjes. Komisioni nuk ka detyrim ligjor dhe as subjektet nuk kanë përse të kenë pritshmëri për konkluzione përfundimtare në këtë raport, përveçse përcjelljes së qartësisë përse ata duhen të mbrohen, e cila është një detyrim i Komisionit në drejtim të kryerjes së një procesi të rregullt ligjor.

12.4. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk konsideron faktin që procedura administrative e zhvilluar në Komision nuk ka përfunduar me raportin për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, duke qenë se ajo ka vijuar më tej me shpjegimet për këto rezultate, të cilat, siç arsyetohet edhe në vijim në këtë vendim, kanë diktuar ndryshimin e analizës financiare të hartuar nga Komisioni në raportin për hetimet paraprake, si dhe konstatohet se procedura administrative është përmbysur me zhvillimin e seancës dëgjimore publike. Nga zhvillimi i kësaj seance dëgjimore, trupi gjykues konstaton se ajo ka nisur me shpjegimin e komisioneres relatores, e cila ka dhënë një përshkrim të hollësishëm të rezultateve të hetimit lidhur me kriteret e vlerësimit të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale të

⁵ Në raportin e rezultateve paraprake të hetimit administrative lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioni ka shprehur se:

Në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, përmbledhur në tabelën me poshtë [...].

subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Hoxha, duke evidentuar elementet e kriterit të pasurisë, për të cilat i ka kaluar barra e provës dhe ka pasqyruar edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me to. Në vijim, subjekti ka dhënë shpjegimet e saj, të cilat Komisioni i ka vlerësuar se nuk janë të mjaftueshme e të afta për të ndryshuar konstatimet e Komisionit, për të cilat subjekti i ka kaluar barra e provës. Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo mënyrë procedimi, si dhe qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, rezulton të jetë i njëjtë me procedurën e aplikuar nga ky organ në çështjet e rivlerësimit, procedurë e cila është gjetur e drejtë dhe është konsideruar garantiste në kuptim të parimeve të procesit të rregullt ligjor edhe nga GjEDNj-ja⁶, në qëndrimet që kjo gjykatë ka mbajtur në gjykimin e çështjeve me ankues subjekte rivlerësimi.

12.5. Në këto kushte, nuk rezulton që Komisioni të ketë vepruar në kundërshtim me parashikimin e nenit 87 të ligjit nr. 44/2015 dhe të mos i ketë dhënë informacion subjektit për çështjet për të cilat po hetohet administrativisht nga ky organ apo të mos e ketë njoftuar atë lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, provat e administruara, si dhe të mos ketë evidentuar çështjet për të cilat subjekti i kalohet barra e provës.

12.6. Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni duhet t'i kishte njoftuar, jo vetëm faktet e konstatuara, por duhet t'i klasifikonte shprehimisht këto fakte në një nga pikat e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që subjekti të kishte mundësi të mbrohej në mënyrë efektive.

12.7. Edhe ky pretendim i subjektit, si një arsye që derivon nga e njëjta logjikë e përdorur në shkaqet e trajtuara më lart, gjendet nga trupi gjykues i padrejtë e i pabazuar. Komisioni ka detyrimin ligjor të bëjë kualifikimin e saktë ligjor të situatave faktike të provuara me vendimin përfundimtar, në të cilën ai vendos për marrjen e masës disiplinore. Ky detyrim i Komisionit lidhet me procesin e tij vendimmarrës dhe arsyetimin e vendimit dhe buron nga neni 57, pika 4, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, por nuk parashikohet si një qëndrim që duhet marrë ndërsa çështja është ende e pazgjidhur, siç pretendon subjekti. Në këtë kontekst, konstatohet se në vendimin objekt gjykimi, Komisioni, duke arsyetuar se [...] *arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha nuk arrin nivelin kualifikues, për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra*, ka treguar se ky organ ka vlerësuar se deklaratimet e subjektit lidhur me pasurinë janë të pamjaftueshme për të konsideruar që ajo ka nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe, për pasojë, ka vendosur aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Identifikimi i dispozitës përkatëse, mbi të cilën është bazuar dhënia e masës disiplinore, duket se ka shlyer në këtë mënyrë detyrimin ligjor në raport me të drejtat e subjektit për t'u mbrojtur në gjykimin e ankimit të tij ndaj vendimit.

12.8. Në referim të sa evidentuar më sipër, në kushtet kur: **(i)** në vendimin e Komisionit objekt kontrolli nuk konstatohen çështje apo gjetje të ndryshme nga ato të trajtuara e analizuara në rezultatet paraprake të hetimit, për të cilat subjekti i ka kaluar barra e provës; **(ii)** subjekti rezulton se ka marrë në dorëzim (me CD) përmbajtjen e dosjes së hetimit administrativ të

⁶ *Shih vendimin e GjEDNj-së A. Xhoxhaj vs Shqipërisë dhe vendimin A. Sevdari vs Shqipërisë;*
<https://kpa.al/gjednj-per-shqiperine/>

krijuar në Komision; **(iii)** subjekti ka zhvilluar një seancë dëgjimore me Komisionin në të cilën komisionerja relatore ka shprehur konstatimet e hetimit administrativ lidhur me kriteret e vlerësimit, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime të plota gjatë kësaj seance; **(iv)** subjekti ka qartësi në vendimin e Komisionit për shkaqet e shkarkimit dhe bazën ligjore mbi të cilat është vendosur masa disiplinore, arrihet në konkluzionin se nuk evidentohen elementë që provojnë pretendimet e subjektit për mungesë të dijenisë për çështjet që afektojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat, siç evidenton përmbajtja e vendimit, kanë shërbyer si shkaqe për dhënien e masës disiplinore e që të kenë shkaktuar cenimin e procesit të rregullt ligjor të zhvilluar ndaj saj.

12.9. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka zbatuar ligjin në raport me gjetjen e rezultateve paraprake të hetimit, sipas së cilës subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat nga bujqësia, pasi legjislativi i kohës nuk ka parashikuar pasjen e dokumentacionit për këto të ardhura, trupi gjykues analizon si vijon.

12.10. *Së pari*, nga përmbajtja e ankimit konstatohet se këto pretendime gjenden të ngritura nga subjekti edhe në shkaqet që lidhen me konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në të cilën ato do të gjejnë trajtim më të plotë e të detajuar.

Së dyti, lidhur me këtë qëndrim, duke iu referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, konstatohet se Komisioni⁷ arsyeton se subjekti *nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar këto të ardhura*, qëndrim i cili potencon mungesën e provueshmërisë së të ardhurave në vetvete dhe nuk është një qëndrim ligjor mbi dokumentacionin që duhej të paraqitej lidhur me faktin nëse subjekti ka paraqitur apo jo prova lidhur me to. Qëndrimi i Komisionit në këtë rast, duket deduktiv, në analizë të të dhënave që janë mundur të përftohen nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për të provuar krijimin e të ardhurave, duke konkluduar se këto të ardhura nuk u provuan. Në këtë mënyrë, trupi gjykues konstaton se pretendimi i ngritur nga subjekti se ky qëndrim përfaqëson një mangësi që cenon procesin e rregullt ligjor gjendet i padrejtë, për sa kohë që vlerësohet se ky qëndrim përfaqëson në fakt një pushtet diskrecionar të ushtruar nga Komisioni në drejtim të vlerësimit të provave, sipas përcaktimeve të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016.

12.11. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni edhe pse indikon aktet që duhet të sjellë subjekti për të provuar të ardhurat nga bujqësia, edhe kur ato janë paraqitur nuk i ka konsideruar, trupi gjykues analizon sa vijon.

12.12. Nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ, rezulton se nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime lidhur me të ardhurat nga toka bujqësore, duke indikuar se për të ardhurat në natyrë të përfituara prej saj subjekti duhet të paraqesë dokumentacion provues, siç janë ato nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, pagesat e sigurimeve shoqërore, pagesat e tatimeve etj. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i

⁷ Në paragrafin 69 të vendimit shprehet se: “Në deklaratën vetting janë deklaruar të ardhura nga subjekti dhe babai i bashkëshortit si vijon: (i) subjekti ka deklaruar të ardhura në natyrë nga toka ndër vite 1992 – 2016, shumën 2.680.000 lekë, e detajuar në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, deklaruar nga babai i bashkëshortit; (ii) babai i bashkëshortit ka deklaruar të ardhura në natyrë nga toka ndër vite 1992 – 2006, shumën 1.100.000 lekë; dhe nga viti 1992 deri në vitin 2016 ka deklaruar shumën 2.680.000 lekë. Por nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar këto të ardhura”.

rivlerësimit, për të vërtetuar të ardhurat nga bujqësia, ka paraqitur në Komision një sërë aktesh të lëshuara nga strukturat pranë Bashkisë Dibër, si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore Dibër. Lidhur me vlerën provuese të këtyre akteve, në vendimin e Komisionit⁸, pasi është bërë një analizë e detajuar e secilës prej tyre, në përfundim është konkluduar se: [...] *Për rrjedhojë, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni nuk i konsideroi vlerat e përcaktuara në shkresat e lëshuara nga Drejtoria e Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave pranë Bashkisë Dibër si të ardhura reale dhe të ligjshme në analizën financiare të huadhënësit, por shpenzimet e jetesës së huadhënësit dhe familjes së tij janë reduktuar sipas shportës së produkteve ushqimore të përlllogaritura nga INSTAT-i, referuar disa rrethanave arsyetuar më sipër.*

12.13. Për sa më sipër, trupi gjykues, edhe në këtë rast, vlerëson se ky qëndrim i Komisionit (siç do të analizohet edhe në vijim) evidenton në mënyrë të qartë, së pari, se nuk ka munguar analizimi i provave të sjella nga subjekti për të ardhurat nga bujqësia dhe së dyti, tregon se informacionin që këto shkresa ofrojnë Komisioni e ka vlerësuar jo të mjaftueshëm e të besueshëm për të provuar të ardhurat e pretenduara nga subjekti, si të siguruara ndër vite nga aktiviteti bujqësor i personave të tjerë të lidhur me to. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast Komisioni ka vepruar brenda fushës së pushtetit të tij diskrecionar për vlerësimin e provave, i cili është një proces autonom e që mbështetet në të dhënat që përfitohen prej tyre dhe në bindjen e brendshme të komisionerëve. Për pasojë, trupi gjykues e gjen edhe këtë shkak ankimi të pa argumentuar dhe të pa mbështetur në prova dhe në ligj.

12.14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nga ana e Komisionit nuk janë respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, pasi vendimi i Komisionit ka një sërë të dhënash personale, sensitive për kunatin dhe kunatën e subjektit, trupi gjykues analizon sa vijon.

12.15. Subjekti i rivlerësimit këtë pretendim e lidh me faktin se në vendimin e Komisionit është pasqyruar informacion/të dhëna, lidhur me gjendjen mjekësore të bashkëshortes së personit tjetër të lidhur, z. P.H. (njëkohësisht edhe kunata e subjektit të rivlerësimit), për të cilën është evidentuar se ka statusin e invalidit dhe përfiton pagesën si “Pension invaliditeti”, duke e konsideruar këtë element të vendimit në shkelje të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9887/2008.

12.16. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 11⁹ jepet përkufizimi i atyre që do të konsiderohen “Pasuri” objekt kontrolli në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe po në të njëjtën dispozitë në pikën 14¹⁰ është shprehur, gjithashtu, se cilët individë konsiderohen si “*persona të tjerë të lidhur*” me subjektin e rivlerësimit, të cilët do t’i nënshtrohen kontrollit të burimit të krijimit të pasurive, që i kanë kaluar subjektit nëpërmjet huas apo dhurimit. Ndërsa në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 është përcaktuar se: “*Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli*

⁸ Shih arsyetimin në faqen 19 dhe 20 të vendimit të Komisionit.

⁹ “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

¹⁰ “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij". Po ashtu, neni 31 vijues i këtij ligji, i emërtuar "Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë" parashikon se: "Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së". Këto dispozita kanë parashikuar qartë se procedura e rivlerësimit kalimtar nuk mund të nisë nëse subjektet e përcaktuar nga ky ligj nuk dorëzojnë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, të njohur ndryshe edhe si deklarata *vetting*.

12.17. Në zbatim të përcaktimeve të mësipërme ligjore, në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, në momentin kur subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën *vetting*, mbi kontrollin e së cilës fillon procesi i rivlerësimit, ajo është dakordësuar për nënshtrimin ndaj procedurës së rivlerësimit kalimtar, si ajo vetë, ashtu edhe personat e lidhur e ata të tjerë të lidhur dhe, për pasojë, në kuptim të përcaktimeve të dispozitave të nenit A¹¹ të Aneksit të Kushtetutës, ka pranuar kufizimin e të drejtave që lidhen me respektimin e jetës private. Në këto kushte, lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se duhet të ishte vetë subjekti i rivlerësimit që në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, në të cilën ka deklaruar/eksponuar si person tjetër të lidhur kunatin dhe familjen e tij, të sigurohej për të pasur dakordësinë e tyre për t'i ofruar organeve të rivlerësimit informacion mbi ekonominë e tyre familjare ndër vite apo për të sqaruar aspekte të tjera të vlerësuar si të nevojshme për t'u verifikuar brenda nevojës për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit. Në këtë kuptim, në zbatim të nenit 179 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, është subjekti i rivlerësimit që ka detyrimin për t'u siguruar që nuk ka pengesa në drejtim ekspozimit të të dhënave personale të personave të tjerë të lidhur, në funksion të aplikimit të saktë dhe të plotë të kërkesave të nenit 52 të këtij ligji, që i ngarkon subjektin barrën e provës për të provuar në nivelin e besueshëm në të tri kriteret e rivlerësimit.

12.18. Për më tepër, trupi gjykues konstaton se në drejtim të mbrojtjes së të dhënave personale vërehet se publikimi i vendimit objekt gjykimi ka respektuar të gjitha kërkesat ligjore për anonimizimin e emrave të personave fizikë apo juridikë, adresat e banimit apo të dhëna të tjera personale, të cilat i nënshtrohen këtij regjimi. Në këtë drejtim, trupi gjykues evidenton se duhet mbajtur në konsideratë se vetë natyra që ka procesi i rivlerësimit kalimtar e bën të pamundur të mos përfshihen në përmbajtjen e vendimit të dhëna, siç janë ato lidhur me pagën, fitimin apo evidentimin e marrëdhënieve nga të cilat ato përfitohen nga subjektet apo persona të tjerë të lidhur, pasi mungesa e tyre e bën përmbajtjen e vendimit të pakuptueshëm e të palexueshëm për publikun, besimin e të cilit reforma në drejtësi synon të rikthejë.

12.19. Në konkluzion të sa analizuar më sipër, lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në të cilin ajo adreson pretendime lidhur me shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, trupi gjykues i gjen ato të

¹¹ Neni A "Kufizimi i të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta" parashikon: 1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi "f", 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

paargumentuara dhe të pabazuara ligjërisht. Në konsideratë edhe të konkluzioneve të mbajtura lidhur me kërkesën për marrjen e provave të reja, të analizuara në paragrafin 11 më sipër, trupi gjykues çmon se nuk gjendet para asnjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, të cilat do të kërkonin shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, për pasojë zhvilloi gjykimin e saj në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit se deklarimi i saj është i pasaktë, pasi nuk përmbush kërkesat e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, është një qëndrim jo i drejtë dhe i pabazuar, pasi në deklaratën *vetting*, e cila është objekt kontrolli sipas ligjit nr. 84/2016, ka dhënë deklarime të sakta, të plota dhe të vërteta për pasuritë e saj dhe të familjes, për të cilat analizon sa vijon.

13.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me deklaratimet e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat i janë nënshtruar kontrollit për vërtetësinë dhe saktësinë e tyre, është arsyetuar dhe konkluduar si vijon:

[...] Përkundër sa pretendon subjekti, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive në deklaratat vjetore merr një peshë specifike të posaçme në rastet kur pasuria nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, çka krijon premisa për dyshime. [...] Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha, ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, germa “a”, e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

13.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se, ndonëse në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2012 (në vijim “DPV”) ajo nuk ka pasqyruar në faqen nr. 3 të saj, huan si burim krijimi të pasurisë apartament në Tiranë, për shkak të rubrikave të këtij modeli, ajo e ka pasqyruar atë saktësisht në faqen nr. 5 të kësaj deklarate, ku deklaroheshin detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë, sipas kontratës së huas së lidhur për këtë qëllim dhe, për me tepër, ajo e ka pasqyruar atë si burim të krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting*.

13.3. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, mori në analizë: deklaratën *vetting*, deklaratimet e subjektit në DPV-në 2010, përmbajtjen e kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010, si dhe shpjegimet që subjekti ka dhënë në ILDKPKI më datë 15.03.2012, nga të cilat konstatoi sa vijon.

13.4. Në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë mbi një apartamentet të ndodhur në Tiranë, të blerë më datë 03.11.2010 dhe si burim krijimi ka deklaruar se kanë shërbyer kursimet e krijuara nga pagat e familjes së saj (duke i detajuar ato sipas viteve të krijimit), si edhe huaja në vlerën 60.000 euro, marrë me anë të kontratës së huas me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010. Ndërsa në rubrikën e deklaratës *vetting* të emërtuar “Detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar huamarrje nga bashkëshorti me kontratë

huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010, në vlerën 60.000 euro, me afat 12-vjeçar, shlyer në progresiv, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2016, vlera 40.000 euro. Serish në deklaratën *vetting*, në rubrikën “*Të dhënat konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010, për huamarrjen nga bashkëshorti në shumën 60.000 euro, të marrë nga vëllai i tij P.H., shlyer në mënyrë progresive vlera 40.000 euro.

13.5. Në DPV-në 2010, në rubrikën “*Ndryshimet e interesave private pasuri e paluajtshme dhe e luajtshme*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje apartamenti me nr. pasurie {***}, me adresë “Rruga {***}”, Tiranë, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2010; vlera 12.000.000 lekë, pa deklaruar burim të krijimit të pasurisë; në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si detyrim: kontratë huaje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010, në shumën 60.000 euro, për blerje apartamenti, me këste vjetore në shumën 6.000 euro, efekti financiar i së cilës fillon nga data 01.11.2010 deri më 01.11.2021, me huadhënës P.H.

13.6. Në përmbajtjen e kontratës së huas, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010, rezulton të jetë përcaktuar se: “*Objekt huaje, që huadhënësi i jep huamarrësit është një vlerë monetare prej 60.000 eurosh, me qëllim që huadhënësi t’i përdorë ato për blerjen e një apartamenti në Tiranë. Kjo vlerë monetare, prej 60.000 eurosh jepet hua pa interes*”.

13.7. Në ILDKPKI¹², më datë 15.03.2012, subjekti, lidhur me burimet e financimit të apartamentit në Tiranë, përveç kursimeve familjare në shumën 4.500.000 lekë, ka deklaruar se kanë shërbyer edhe të ardhurat e siguruara nga kontrata e huas me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2010, në shumën 60.000 euro.

13.8. Mbi bazën e këtyre deklarimeve, Komisioni në rezultatet paraprake të hetimit ka konstatuar dhe i ka kaluar barrë prove subjektit për shkak të mosdeklarimit në DPV-në 2010 të burimeve të krijimit të pasurisë apartament në Tiranë, konkretisht, të pakësimit të *cash*-it të akumuluar në periudhën 2006 – 2010 dhe të huas prej 60.000 eurosh. Në përgjigje të këtij konstatimi, subjekti, me shpjegimet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit, ka shpjeguar se: *Mosdeklarimi i krijimit të burimit të plotë të pasurisë ka qenë një pasaktësi. Kam deklaruar vlerën e huas dhe shlyerjen e saj çdo vit dhe kam menduar se ka qenë e qartë pjesa tjetër e krijuar me burim nga kursimet ndër vite, për sa kohë që këto kursime janë pakësuar. Në asnjë moment nuk ka qenë synimi për të fshehur burimin e krijimit të saj dhe për këtë arsye çmoj se një pasaktësi e tillë duhet të vlerësohet drejtë nga ana Juaj. Lidhur me pasaktësitë në*

¹² Me ankimin subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur edhe një shkresë të emërtuar “*Kthim përgjigje*” të drejtuar ILDKPKI-së. Siç kjo shkresë e evidenton kthimi përgjigjes është bërë nga subjekti në përgjigje të shkresës së ILDKPKI-së nr. {***}, datë 21.02.2012 dhe në fund mban shënimin: “*U mor në dorëzim në zyrën e protokollit të ILDKPKI-së më datë 15.03.2015*” e pajisur me një nënshkrim. Nga analizimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se ILDKPKI-ja shkresën/aktin “*Kthim përgjigje të subjektit Irena Hoxha*” të vitit 2012 nuk e ka përfshirë në dosjen që ky organ ka krijuar me qëllim hartimin e raportit të kërkuar nga neni 30 i ligjit nr. 84/2016 dhe as në përgjigjen e përcjellë nga ky organ Komisionit, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.2020, me anë të së cilës i vë në dispozicion shpjegimet e dhëna në ILDKPKI ndër vite nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë praktikë, shpjegimi që ILDKPKI-ja i përcjell Komisionit ka të bëjë vetëm me shpjegimet që subjekti ka dhënë më datë 14.01.2014.

deklarimet periodike vjetore, të pashoqëruar me dyshime për fshehje të pasurisë, Komisioni ka mbajtur tashmë një qëndrim të konsoliduar në vendimet e marrë deri tani nga trupat e saj gjykuese, duke i konsideruar se nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.

Në përfundim të procesit, rezulton se Komisioni ka konsideruar si një nga shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit edhe mosdeklarimin prej saj të burimit të krijimit të apartamentit në Tiranë, në vitin 2010, duke e cilësuar atë si në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

13.9. Në analizë të sa evidentuar më sipër, trupi gjykues konstaton, *së pari*, se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, e cila është objekt kontrolli në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, të gjitha burimet e krijimit të pasurisë apartament në Tiranë, përfshirë kursimet në vite dhe huan e marrë personit tjetër të lidhur, z. P.H., duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat e nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me deklarimin e plotë të pasurisë dhe të dhënave të tjera të saj. Në këtë optikë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka bërë një deklarami të pasaktë të pasurisë, sipas interpretimit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar dhe i pambështetur në ligj, për sa kohë që ajo e ka deklaruar saktë në deklaratën *vetting*, në raport me të cilën duhet analizuar ky aspekt i kontrollit të pasurisë. Pasaktësitë e deklarimeve të kryera në deklaratat periodike vjetore nuk janë konsideruar nga jurisprudenca e Kolegjit¹³ se mund të ngrihen në nivelin e një shkak shkakimi më vete, qëndrim i cili vlen të silltet në vëmendje edhe në këtë rast për sa kohë që konkluzioni i Komisionit i referohet mungesës së deklarimit të burimit, si një pasaktësi në plotësimin e DPV-së së vitit 2010.

13.10. Përveç sa më sipër, trupi gjykues konstaton se analiza e Komisionit për pasaktësinë në deklarimin e burimit të krijimit të pasurisë apartament në DPV-në 2010, nuk rezulton të jetë e saktë edhe në kuptim të analizës së fakteve dhe ligjit. Në drejtim të saktësisë së këtij deklarimi, siç subjekti pretendon në ankim, duket se deklarimi i bërë prej saj në DPV-në 2010 është në përputhje me kërkesat e diktuar nga modeli i deklaratës së deklarimit të pasurisë të përdorur në atë vit nga subjektet deklarues, në të cilin nuk specifikohet se duhet të deklaroheshin burimet e krijimit të pasurisë së shtuar. Gjithashtu, trupi gjykues, përveç sa më sipër, konstaton se subjekti lidhur me huan ka kryer deklarime dhe ka lënë gjurmë për përdorimin e saj si burim për apartamentin në Tiranë edhe në DPV-në 2010, duke përdorur rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë, veprim të cilin nuk rezulton ta ketë kryer për

¹³ Në vendimin e Kolegjit (JR) 28/2020, është arsyetuar, ndër të tjetra, se:

Së dyti, nuk rezulton asnjë e dhënë e dalë gjatë deklarimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ në Komision se subjekti ka përdorur pasurinë e tij likuiditet për të krijuar ndonjë pasuri apo për të përballuar ndonjë shpenzim përgjatë periudhës që i është nënshtruar kontrollit. Në këto kushte, kur shpenzimi apo përdorimi i këtyre pasurive, të deklaruara cash e të justifikuar ligjërisht, nuk ka shërbyer si burim krijimi për asnjë pasuri të krijuar prej subjektit apo për të përballuar ndonjë transaksion financiar të kryer prej tij, situatë faktike e cila do të kërkonte domosdoshmërisht saktësinë e deklarimeve periodike të subjektit për vlerën e kësaj pasurie, sipas kërkesës së nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmon se pasaktësia e këtyre deklarimeve nuk afekton verifikimin e ligjshmërisë së burimit për të gjitha pasuritë e subjektit.

Në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 22/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit B.H. është arsyetuar:

Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklarimet periodike të subjektit kanë pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, pasaktësitë në deklarimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

përdorimin e kursimeve në *cash*, e cila eventualisht mund të ishte konsideruar si një problematikë që do të afektonte konsiderimin e këtij burimi mes atyre të përdorur për blerjen e këtij apartamentit, por që Komisioni e ka njohur si tillë, duke e lënë pa peshë këtë pasaktësi.

13.11. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, duke konsideruar mbi të gjitha faktin që subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në kuptim të përcaktimeve të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 31 të ligjit nr. 84/2016, ka dhënë deklarime të plota, lidhur me burimet e financimit të përdorura për blerjen e apartamentit në Tiranë (huan dhe kursimet në *cash*), të cilat i ka konfirmuar si të tilla edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, çmton se mosdeklarimi në DPV-në 2010 është një pasaktësi, e cila nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është i gabuar dhe jo i bazuar ligjërisht.

- 14.** Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit se *huadhënësi P.H., ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e shumës së dhënë hua në masën 60.000 euro në vitin 2010, është i gabuar, dhe jo i bazuar në ligj pasi:*
- (a) Shuma e dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016 është krijuar nga huadhënësi me burime të ligjshme të siguruara, nga puna në emigracion dhe nga të ardhurat nga bujqësia. (b) Metodologjia e aplikuar nga Komisioni për analizimin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur z. P.H. për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit është e gabuar, jo në përputhje me situatën faktike si dhe në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.*

14.1. Komisioni, lidhur me huan e marrë prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga vëllai i tij, z. P.H., të cilën subjekti e ka deklaruar si një nga burimet e financimit të apartamentit të blerë në Tiranë në vitin 2010, ka kryer kontrollin dhe verifikimin e burimeve të krijimit të kësaj shume prej vëllait të bashkëshortit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, duke përllogaritur në analizën financiare të gjithë të ardhurat e dokumentuara prej tij si të fituara në Greqi dhe ato të dokumentuara në Shqipëri. Po ashtu, Komisioni, për periudhën e analizuar për familjen e huadhënësit, ka konsideruar: **(i)** shpenzime jetese të reduktuara në masën rreth 50% të vlerës së përcaktuara si kosto jetese nga INSTAT, për shkak të faktit se ishte një familje bujqësore, pavarësisht se nuk kishte arritur të dokumentonte të ardhurat nga bujqësi; si dhe **(ii)** shpenzimet për një ndërtim të bërë në Tiranë.

Pas kryerjes së analizës, mbështetur në qëndrimet e mësipërme, Komisioni ka arritur në konkluzionin se personi tjetër i lidhur ka qenë në pamundësi të krijojë me burime të ligjshme shumën prej 60.000 eurosh, e dhënë hua subjektit në vitin 2010, për një vlerë prej (-) 3.243.707 lekësh.

14.2. Subjekti kundërshton analizën e mësipërme të Komisionit, duke pretenduar se metodologjia e aplikuar në këtë analizë është e gabuar dhe jo e drejtë, mbështetur në pretendimet e renditura dhe analizuara si më poshtë.

14.3. Subjekti pretendon se metodologjia dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni nuk janë në përputhje me orientimet e Kolegjit të dhëna në vendimin nr. 15, datë 17.07.2019,

në të cilin arsyetohet se: *“Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur”*. Sipas këtij pretendimi, nëse do të respektohej orientimi i dhënë nga Kolegji në vendimin njehsues të sipërcituar, atëherë do të rezultonte se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për të dhënë huan, duke konsideruar edhe vetëm të ardhurat e ligjshme dhe të dokumentuara nga autoritetet greke.

14.3.1. Lidhur me pretendimin e mësipërm të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se ai konsiston në faktin se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për personin tjetër të lidhur, z. P.H., janë përfshirë si shpenzim investimet e kryera prej tij deri në momentin e dhënies së kësaj huaje, që kanë të bëjnë respektivisht me shumën 825.104 lekë të përlllogaritur¹⁴ si të shpenzuara për ndërtimin e katit të dytë të një objekti në Sharrë, Tiranë, në të cilin huadhënësi ka rezultuar pronar, si dhe është përfshirë si shpenzim shuma prej 123.183 lekësh e përdorur nga huadhënësi për blerjen e një automjeti.

14.3.2. Në të kundërt, subjekti ka kërkuar në ankim dhe parashtime, që në referim të jurisprudencës së Kolegjit shumat e shpenzuara nga huadhënësi për ndërtimin në Sharrë dhe për blerjen e automjetit të përjashtohen nga analiza financiare, duke pretenduar përlllogaritjen e mundësisë për kursim të huadhënësit mbi bazën e një analize bazike mes të ardhurave dhe shpenzimeve.

14.3.3. Trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim të subjektit në konsideratë të jurisprudencës së tij të pretenduar si të zbatueshme edhe nga vetë subjekti në rastin konkret, por edhe në konsideratë të rrethanave faktike të rastit. Vlen të sillet në vëmendje se qëllimi i Kolegjit në përcaktimin e jurisprudencës, si më sipër përmendur, ka synuar të mos rëndojë në mënyrë jo proporcionale subjektet e rivlerësimit me pasoja që vijnë nga kryerja e aktiviteteve që kanë krijuar të ardhura informale për personat e tjerë të lidhur, duke qenë se është vlerësuar se mosrespektimi i ligjit tatimor prej këtyre të fundit nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore subjektet e rivlerësimit. Në këtë logjikë, Kolegji në jurisprudencën e tij, krahas kryerjes së një analize bazike financiare për këtë kategori (*të ardhura të ligjshme dhe shpenzime jetese*), ka potencuar vazhdimisht në mënyrë persistente që kjo analizë duhet të jetë e arsyeshme dhe e logjikshme në mënyrë që të mos shndërrohet në një kontroll mekanik që shmang vlerësimin logjik të situatave konkrete. Nën këtë frymë, trupi gjykues vlerësoi në rrethanat konkrete pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

14.3.4. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se personi tjetër i lidhur nuk duhet të ngarkohet me shpenzimet për investimin e kryer në ndërtimin e objektit në Sharrë, Tiranë dhe blerjen e automjetit, nuk ka pretenduar dhe as ka paraqitur dokumentacion se ai dhe familja e tij kanë pasur të ardhura të tjera të ligjshme, të cilat janë përdorur për financimin e tyre. Subjekti ka pretenduar se burimi i të ardhurave të përdorura prej personit tjetër të lidhur është puna në emigracion sezonal në Greqi dhe të ardhurat nga bujqësia. Në referim të këtyre të dhënave konstatohet se, ndërsa Komisioni ka konsideruar të ardhurat nga emigracioni që

¹⁴ Të përlllogaritur sipas një metodologjie të evidentuar në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi.

janë provuar prej subjektit sipas standardit të së ardhurës së ligjshme, nuk ka përfshirë në të të ardhurat e pretenduara të krijuara nga bujqësia, por që janë shoqëruar me një reduktim, gati në masën 50% të shpenzimeve të jetesës për këtë familje, duke krijuar një balancë të pranueshme mes pretendimeve të subjektit, realitetit të prezumuar se familjet bujqësore përdorin produktet e tyre për ushqim dhe një kalkulimi logjik të nivelit të shpenzimeve të konsumuara nga këto familje për jetesë. Në këtë kuptim, trupi gjykues, siç do të elaborohet edhe në vijim të këtij arsytimi, nuk konstaton asnjë burim të pretenduar prej subjektit se ka prodhuar të ardhura, i cili të ketë krijuar bindjen se ka ekzistuar dhe të mos jetë përfshirë në këtë analizë në një mënyrë apo tjetër.

14.3.5. Për këto arsye, trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit për përjashtimin e shpenzimeve të kryera për investimet nga analiza financiare e personit tjetër të lidhur, duke konfirmuar analizën e Komisionit në këtë rast¹⁵.

14.4. Subjekti ka kundërshtuar analizën e kryer në Komision për personin tjetër të lidhur, për shkak se Komisioni nuk i ka njohur të ardhurat nga toka bujqësore, në pronësi dhe asaj në bashkëpronësi me prindërit e tij, si dhe nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara prej tij në emigracion në vitet 1992-2000.

14.4.1. Sipas pretendimit të subjektit, huadhënësi ka pasur të ardhura nga punimi i tokës bujqësore, me sip. 8.075 m², në bashkëpronësi të prindërve të tij, bashkëshortit të subjektit dhe vetë personit tjetër të lidhur. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 22.07.2021, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Bashkia Dibër, rezulton se këto të ardhura përllogariten në shumën 4.951.000 lekë. Nëse kësaj shume i zbritet shuma prej 850.000 lekësh, që përbën vlerën e produkteve të përfituara në natyrë nga familja e vetë subjektit, atëherë vlera e të ardhurave të përfituara nga familja e kumatit të saj, personit tjetër të lidhur, është në vlerën 4.101.000 lekë dhe kjo shumë duhet të merret në konsideratë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të huadhënësit. Gjithashtu, subjekti pretendon se Komisioni, bazuar në informacionin që ofron shkresa, me nr. {***} prot., datë 30.07.2021, e lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë Bashkisë Dibër, duhet të kishte vlerësuar si të ardhura të ligjshme të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të vetë personit tjetër të lidhur, z. P.H., të krijuara në periudhën 2001 – 2010, në shumën 1.610.000 lekë dhe t'i përllogariste ato në analizën financiare. Mbi këtë të dhënë, Komisioni duhet të përcaktonte të ardhurën vjetore edhe për periudhën 1991 – 2000, për të cilën nuk ka të dhëna dokumentare, minimalisht në të njëjtën vlerë prej 161.000 lekësh në vit, si dhe ta përllogariste atë në një total prej 1.449.000 lekësh.

14.4.2. Lidhur me këto të ardhura, Komisioni në vendim ka arsyetuar se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të huadhënësit P.H., si dhe të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të babait të tij H.H., referuar fakteve, si vijojnë: (i) në përmbajtjen e shkresave të përpiluara nga Drejtoria e Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë Bashkisë Dibër, nuk ka të dhëna nëse përllogaritjet e të ardhurave nga toka bujqësore janë bazuar në ndonjë evidencë në kohë reale, por duket se janë bazuar në deklaratimet e

¹⁵ Pavarësisht këtij qëndrimi, trupi gjykues kreu edhe një vlerësim alternativ/garantist, sipas jurisprudencës së Kolegjit, pretenduar prej subjektit, e cila trajtohet në vijim të këtij arsytimi.

subjektit/familjarëve të saj e, për rrjedhojë, vlerat e referuara në këto shkresa nuk krijojnë bindjen se janë të ardhura reale të huadhënësit, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 60.000 euro; **(ii)** gjatë gjithë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga bujqësia janë të ardhura në natyrë për përdorim vetjak; **(iii)** ka qenë e paqartë përse, sipas subjektit, një pjesë e të ardhurave nga toka bujqësore në emër të vjehrrit H.H. dhe pikërisht shuma 4.101.000 lekë është përfituar vetëm nga djali i tij, huadhënësi P.H., i cili shkante e vinte në Greqi dhe jo nga dy djemtë e tjerë, të cilët banonin në Shqipëri.

14.4.3. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e sipërpërshkruara të subjektit lidhur me njohjen e të ardhurave nga bujqësia për personin tjetër të lidhur, duke analizuar të dhënat e rezultuara nga aktet e administruara prej Komisionit, në funksion të kontrollit të qëndrimit të këtij të fundit në këtë drejtim, sipas së cilit këto të ardhura nuk janë provuar dhe, për pasojë, as janë njohur si të tilla në analizën financiare.

14.4.4. Sipas dokumentacionit të administruar në Komision, trupi gjykues konstatoi se subjekti, për të provuar të ardhurat e siguruar nga toka bujqësore me sip. 8.075 m², në fshatin Vakuf, Dibër, ka paraqitur në Komision aktet:

- i.** Shkresën me nr. {***} prot., datë 22.07.2021¹⁶, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë Bashkisë Dibër, me anë të së cilës, në përgjigje të kërkesës së subjektit të datës 14.07.2021, jepet informacion lidhur me të ardhurat nga toka bujqësore, frutikultura dhe nga gjedhët që dispononte z. H.H. (vjehrrit të subjektit) për periudhën 1992-2020. Në këtë shkresë evidentohet se nga aktiviteti i mësipërm bujqësor e me të imta, në periudhën 1992 – 2020, janë siguruar të ardhura në vlerën rreth 4.900.000 lekë.
- ii.** Shkresën me nr. {***} prot., datë 30.07.2021¹⁷, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë Bashkisë Dibër, që i drejtohet subjektit të rivlerësimit, duke iu referuar shkresës së mëparshme nr. {***} prot., datë 22.07.2021, e cila evidenton se të ardhurat e z. P.H., për tokën bujqësore me sip. 1000 m², për periudhën 2001 – 2010, janë në shumën 1.610.000 lekë .
- iii.** Shkresën nr. {***} prot., datë 28.09.2021¹⁸, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë Bashkisë Dibër, në të cilën jepen të dhëna për

¹⁶ Kjo shkresë përcakton në përmbajtjen e saj se: “Përlllogaritja e të ardhurave është bërë nga specialistet pranë Drejtorisë së Bujqësisë Dibër, referuar faktit se na është dhënë një detaj për kulturat e mbjella ndër vite për gjedhët dhe pulat dhe kosheret e bletëve”.

¹⁷ Në këtë shkresë vijuese të Drejtorisë së Bujqësisë Dibër, shprehet se: “E shohim të arsyeshme të qartësojmë sa më poshtë:- Të dhënat për sip. e tokës bujqësore dhe numrin e krerëve janë marrë të mirëqena siç janë dërguar nga ju: - struktura e kulturave të të mbjellave është paraqitur siç është dërguar; - nuk disponojmë të dhëna fizike për personat e lidhur me rendimentin e kulturave por i jemi referuar rendimentit mesatar në rang Bashkie për periudhën që kërkohet; - nuk është përfshirë puna e fuqisë punëtore pasi zakonisht kryhet nga trangu familjar; - Nuk disponojmë statistika për çmimet ndër vite por janë siguruar në mënyrë verbale. Institucioni ku dërgohet informacioni do të gjykojë vetë nëse është i pranueshëm informacioni i dërguar në këtë formë”.

¹⁸ Në shkresën e tretë të Drejtorisë së Bujqësisë Dibër, shprehet se: “Në këtë shkresë pasqyrohet se: “Për llogaritjen e të ardhurave nga kultivimi i kulturave bujqësore ndër vite, jemi bazuar në bonitetin e tokave në strukturat e mbjella vit pas viti, si dhe rendimentin mesatar për këto kultura”. Për çmimet nga kulturat e mbjella janë marrë në konsideratë çmimet e tregut lokal sipas viteve të prodhimit kur kanë dalë të ardhurat nga këto kultura. Për të ardhurat nga blegjoria është marrë në konsideratë raca e lopës në pronësi të familjes, niveli i të ushqyerit dhe çmimi lokal i tregut për qumështin dhe mishin. Për sa i përket mjaltit është vepruar duke konsideruar rendimentin mestar dhe çmimet mesatare të tregut”.

bonitetin e tokës me sip. 8075 m², në emër të z. H.H. dhe tokës me sip. 1000 m² në emër të z. P.H.

14.4.5. Nga informacioni i mësipërm i përfutur prej tre shkresave të Drejtorisë së Bujqësisë, pranë Bashkisë Dibër, trupi gjykues konstaton se: **(i)** Bashkia Dibër në këto shkresa nuk referon në asnjë lloj dokumenti ligjor, si akt-inspektim, statistika, skema rimbursimi apo kërkesa lidhur me to, të hartuar gjatë periudhës 1992-2020, që të evidentojnë ndonjë verifikim në terren në tokat e H. e P.H. dhe as jep të dhëna të kohës të hartuara para nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, që indikojnë mbjelljen e këtyre tokave me kulturat e pretenduara apo mbajtjen në to të gjedhëve e bletëve; **(ii)** mungesa e këtij evidentimi potencohet në relevancën e tij me çështjen në analizë, në kushtet kur kryefamiljari, i cili ka marrë tokën (sipërfaqen 8.075 m²), z. H.H., ka jetuar me subjektin në Peshkopi nga viti 2001 deri në vitin 2010 dhe nga viti 2010 e aktualisht është zhvendosur në Tiranë. Po ashtu, edhe kunati i subjektit është e provuar se nga viti 1998 e deri në vitin 2010 më së shumti ka jetuar në Greqi dhe bashkëshortja e tij është pjesë e skemës së përfitimit të pagesave të invaliditetit, duke sugjeruar për mungesë të mundësisë fizike për të administruar tokën bujqësore, siç pretendon subjekti; **(iii)** vërtetësia e tërësisë së informacionit, që japin shkresat e mësipërme të Bashkisë Dibër, mbetet e diskutueshme, për sa kohë imputet/të dhënat mbi të cilat drejtorja e përkatëse ka përllogaritur të ardhurat (fakti i mbjelljes së tokës, lloji i kulturës bujqësore, numri i gjedheve, pulave e koshereve), siç referojnë vetë këto shkresa janë dhënë/ofruar nga subjekti i rivlerësimit, pasi rezulton se ky institucion nuk ka të dhëna burimore që konfirmojnë ndonjë informacion lidhur me to.

14.4.6. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se pagimi i taksës së tokës dhe kryerja e pagesave të sigurimeve shoqërore, si fermer nga ana e z. P.H. dhe bashkëshortes së tij, janë elementë që nuk provojnë mbjelljen dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore, pasi pagesa e taksës së tokës është detyrim ligjor që nuk lidhet me kultivimin ose jo të saj, por me të drejtat e pronësisë/bashkëpronësisë¹⁹ mbi të. Po ashtu, edhe pagesa e sigurimeve shoqërore për ta, në cilësinë e tyre si “fermerë”, nuk provon punimin/shfrytëzimin e tokës dhe as sigurimin e të ardhurave prej saj, pasi si kusht i regjistrimit në këtë skemë mjafton që i interesuari të provojë faktin se banon në fshat dhe se ka në pronësi tokë bujqësore.

14.4.7. Për arsyet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë qëndrimi i Komisionit që nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga toka bujqësore për personin tjetër të lidhur, duke qenë se nga të dhënat e akteve të mësipërme, me të cilat subjekti synon të provojë të ardhurat e krijuara në vite nga familja bujqësore, rezulton se shifrat e përcjella nga Drejtorja Bujqësore dhe Administrimit të Ujërave, në Bashkinë Dibër, janë empirike të hartuara mbi deklaratimet e subjektit dhe personave të interesuar, shumë kohë pas krijimit të tyre dhe në funksion të nevojave të subjektit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, ato mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara për efekt të këtij procesi, situatë që me të drejtë nuk mund të prodhojë një shifër për t’u llogaritur si e ardhur në analizën financiare të personit tjetër të lidhur. Krahas këtij arsyetimi, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit për

¹⁹ Në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave për taksën e tokës bujqësore informohet se: Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë, në pronësi të tatimpaguesit. Pronësia e këtyre tokave bujqësore përcaktohet në dokumentet që e vërtetojnë atë. Niveli i taksave për çdo kategori minimale të bazës së taksës dhe kategoritë minimale të tokës bujqësore jepen si më poshtë. [...]. shih <https://arkiva.financa.gov.al/taksa-mbi-token-bujqesore/>

shfrytëzimin prej personit tjetër të lidhur të sipërfaqeve të tokës në pronësi (1.000 m²) e në bashkëpronësi (8.075m²), përveçse i paprovuar duket edhe jo realist, qoftë në të drejtat e tërhequra prej këtyre pronave, sipas të cilave personi tjetër i lidhur përfiton më shumë se të gjithë bashkëpronarët e tjerë, qoftë në drejtim të masës së sipërfaqes së tokës dhe mundësisë së saj për pjellori bujqësore, në raport me raste të tjera të ngjashme të shqyrtuara në Kolegj²⁰.

14.4.8. Përveç sa më sipër, subjekti, duke sjellë në vëmendje dhe disa qëndrime të mëparshme të Komisionit²¹, ka pretenduar në alternativë se për efekt të analizës financiare të huadhënësit si person tjetër i lidhur duhet të përfshihen të ardhura nga toka bujqësore së paku në masën e shpenzimeve të jetesës, me argumentin se toka i është dhënë fshatarëve me qëllim për të siguruar jetesën me të ardhurat e gjeneruara prej saj, trupi gjykues analizon sa vijon.

14.4.9. Lidhur me rastet e trajtuara në vendimin e Komisionit të evidentuara në ankim prej subjektit, të cilat pretendohet se zgjidhin situata të njëjta me atë të subjektit, në mënyra dhe standarde të ndryshme, trupi gjykues konstaton se: (i) në to trajtohen kryesisht të ardhurat nga toka bujqësore që disponojnë vetë subjektet apo prindërit e tyre, të cilat shërbejnë për krijimin e pasurive të subjektit dhe nuk shtrihen në të ardhurat që dhurojnë vëllezërit apo motrat e subjekteve, të cilët, sipas një tradite dhe realiteti të njohur, krijojnë familjet e tyre dhe nuk kanë të njëjtën afërsi/ndjeshmëri apo përgjegjësi si ajo mes prindërit dhe fëmijës; (ii) pretendimet për përfitime të gjeneruara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në këto vendime që referohen nga subjekti janë në vlera më të vogla, në raport me ato që pretendohen në rastin objekt shqyrtimi; (iii) në asnjë nga rastet e referuara nuk rezulton që Komisioni, për shkak të disponimit të tokës bujqësore, nga subjektet e rivlerësimit apo personave të lidhur apo të tjerë të lidhur, të ketë parashikuar në masën 0 (zero) lekë shpenzimet për kosto jetese, pasi në të gjitha këto vendime është reduktuar vlera e tyre në analizën financiare. Kolegji, në një situatë të ngjashme, në vendimin që subjekti ka referuar në ankim (JR) 18/2021 ka arsyetuar se: *“Por duke konsideruar deri në një masë të besueshme faktin se ekonomia familjare është ndihmuar nga kultivimi i prodhimeve bujqësore, diferenca negative e konstatuar mbi bazë dokumentesh [trajtuar në paragrafët më sipër] nuk duket se është realisht ajo”*. Ky qëndrim i Kolegjit evidenton se të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të përfituara nga bujqësia nuk janë përfshirë automatikisht si të tilla në analizën financiare, por së bashku me elementet e tjerë kanë shërbyer si të dhëna që ndihmojnë për të vlerësuar diferencën negative mbi bazën e parimit të proporcionalitetit.

14.4.10. Nga informacioni i akteve të fashikullit administrativ, rezulton se në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”²², toka me sip. 8075 m², në fshatin

²⁰ Shih vendimet e Kolegjit (JR) 3/2023 dhe (JR)12/2023.

²¹ Në ankim subjekti i rivlerësimit referon vendimet e Komisionit nr. 234, datë 04.02.2020; nr. 229, datë 08.01.2020; nr. 241, datë 26.02.2020; nr. 372, datë 22.04.2021; nr. 191, datë 26.07.20219, si dhe vendimin e Kolegjit (JR) 18/2021.

²² Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 7051, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, me VKM-në nr. 255, datë 02.08.1991, janë miratuar “Kriteret e ndarjes së tokës bujqësore (ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 21.3.1994) është përcaktuar sa vijon:

1.Toka ndahet sipas gjendjes aktuale të sipërfaqes që ka kooperativa bujqësore dhe numrit të frymëve. Për kooperativat bujqësore që si subjekte përbëhen nga më shumë se një fshat, komisioni i tokës në rreth përcakton tokat bujqësore të çdo fshati, duke ndërtuar raporte të drejta të sipërfaqes së tokës për frymë të çdo fshati me atë në shkallë kooperative.

Vakuf, Dibër, i është dhënë familjes bujqësore të z. H.H., e cila në atë kohë përbëhej nga 6 (gjashtë) anëtarë, përkatësisht H.H. kryefamiljar, bashkëshortja dhe 4 (katër) djemtë e tyre, duke prezumuar në këtë mënyrë se kjo sipërfaqe toke ka qenë vlerësuar e mjaftueshme për të krijuar të ardhura për të përballuar jetesën e një familje bujqësore me 6 (gjashtë) anëtarë. Ndërkohë, në situatën konkrete, referuar pretendimeve të subjektit, kërkohet të pranohet se kjo sipërfaqe toke (e projektuar sipas ligjit për të përballuar jetesën e gjashtë personave) ka shërbyer për të krijuar të ardhura për prindërit e bashkëshortorit të subjektit për familjen e subjektit dhe për familjen e të huadhënësit, gjithsej 13 persona, pa konsideruar këtu dy vëllezërit e tjerë të bashkëshortit të subjektit (P.H. dhe H.H.), të cilët rezultojnë të jenë bashkëpronarë, por që nuk pretendohet të kenë pasur përfitime nga prona, ndonëse me të drejta të njëjta si bashkëshorti i subjektit dhe prindërit e tij. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se pothuaj të gjitha të ardhurat e përfituara nga sipërfaqja e tokës bujqësore janë marrë prej familjes së personit tjetër të lidhur dhe të asaj vetë, duke lënë jashtë këtij përfitimi bashkëpronarët e tjerë pa arsye, duket i pabesueshëm dhe e bën të pamundur për konsiderim pretendimin se familja e personit tjetër të lidhur jetonte me të ardhurat e krijuara nga toka e gjithë bashkëpronarëve të tjerë, ndërsa të ardhurat e krijuara prej punës në emigracion iu dhanë të gjitha subjektit për të financuar blerjen e apartamentit.

14.4.11. Për sa më sipër, përveçse sipërfaqja e tokës që pretendohet se është shfrytëzuar prej personit tjetër të lidhur, duket e vështirë të ketë siguruar të ardhura që shkonin vetëm për familjen e tij, në kushtet kur personat që duhet të përfitonin prej saj ishin më shumë, pretendimi për përcaktimin e të ardhurave nëpërmjet barazimit të vlerës së tyre me ato të shpenzimeve të jetesës mbetet një pretendim i pambështetur në një logjikë financiare në funksion të ndërtimit të një analize financiare objektive dhe të mbështetur në të dhëna të ofruara nga dokumentacioni ligjor.

14.5. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të personit tjetër të lidhur, z. P.H., duhen përfshirë të ardhurat e krijuara nga huadhënësi në emigracion në periudhën nga vitet 1992 – 2000, trupi gjykues analizoi sa vijon.

14.5.1. Komisioni për huadhënësin P.H. ka përfshirë në analizën financiare si të ardhura vetëm ato të siguruar nga emigracioni sezonal në Greqi në vitet 2000 – 2010, me argumentin se për to subjekti ka mundur të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues të kohës së krijimit, që provon bindshëm të ardhurat e siguruar nga puna në emigracion dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Ndërsa për sa i përket të ardhurave të huadhënësit P.H. nga puna në emigracion në Greqi, për periudhën 1992 – 2000, në vendimin e Komisionit është konkluduar se: “[...] subjekti ka deklaruar se është në kushtet e pamundësisë objektive për t’i vërtetuar ato, sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që të vërtetojë qoftë dhe në mënyrë indirekte që ky shtetas ka jetuar dhe punuar në Greqi gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të lejes së qëndrimit në shtetin grek për vitin 1998 dhe, për rrjedhojë, nuk ka vërtetuar pamundësinë për të vërtetuar të ardhura të tij gjatë kësaj periudhe”.

2 . Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991.

14.5.2. Në ankim, subjekti pretendon se huadhënësi së bashku me vëllain e tij P.H. ka qenë dhe ka punuar në Greqi edhe për periudhën 1992 – 2000. Në kushtet e pamundësisë për të provuar me dokumente shkresore të ardhurat e realizuara nga z. P.H., subjekti ka përdorur si të dhënë indirekte të ardhurat që ka realizuar kunati tjetër, z. P.H., në këtë periudhë.

14.5.3. Për të provuar të ardhurat nga emigracioni të z. P.H., subjekti ka sjellë në vëmendje faktin se ai ka depozituar në shoqërinë huamarrëse “{***}”, në emër të bashkëshortit të subjektit, vlerën 1.150.000 lekë dhe 390.000 dhrahmi, më datë 24.10.1996 dhe në vitin 2000 ka blerë shtëpi banimi së bashku me vëllain tjetër, z. P.H., në Tiranë, në vlerën 1.500.000 lekë. Duke qenë se, sipas subjektit, në vitet 1992 – 2000 të dy vëllezërit kanë punuar bashkë dhe kanë pasur pothuaj të njëjtat të ardhura, në rastin e personit tjetër të lidhur, z. P.H., ato u lanë në ruajtje të babait të tij dhe u përdorën më pas për nevojat e familjes. Subjekti pretendon se nën logjikën e shifrave të mësipërme dhe në mungesë të dokumentacionit provues për këtë periudhë, përveç lejes së qëndrimit (si leje pune) në vitin 1998, të ardhurat për personin tjetër të lidhur, duhet të llogariten në vlerën rreth 2.800.000 lekë, e cila duhet t’i shtohet të ardhurave të tjera të pretenduara.

14.5.4. Trupi gjykues, në analizë të akteve që subjekti ka paraqitur në Komision për të provuar të ardhurat nga periudhën 1992 – 2000 të realizuara nga personi tjetër i lidhur, z. P.H., konstaton se: **(i)** aktet dhe pretendimet e subjektit synojnë të provojnë të ardhurat e vëllait tjetër të bashkëshortit të saj, prej të cilit ajo nuk ka tërhequr të drejta pasurore, e i cili nuk ka një status në procesin e saj të rivlerësimit; **(ii)** edhe për të provuar të ardhurat e z. P.H., subjekti ka sjellë dokumentacionin që ai ka depozituar në shoqërinë huamarrëse “{***}”, në emër të bashkëshortit të subjektit, vlerën 1.150.000 lekë dhe 390.000 dhrahmi, më datë 24.10.1996, të dhëna që në versionin e pretenduar provojnë vetëm faktin se ky individ i ka zotëruar këto para në këtë kohë, por nuk provojnë burimin e krijimit të tyre dhe as gjenerimin e tyre nga puna në emigracion; **(iii)** subjekti nuk ka paraqitur dokumente të plota që provojnë punësimin e rregullt në shtetin grek të z. P.H. e aq më pak që ai të ketë punuar së bashku me z. P.H. e të jenë paguar e të kenë kursyer në mënyrë të njëjtë; **(iv)** nuk rezulton ndonjë dokumentacion që provon pagimin e detyrimeve tatimore nga z. P.H., që do të konfirmonte në këtë rast krijimin e të ardhurave në emigracion, si dhe rezulton se as subjekti nuk jep shpjegime apo qëndrim nëse për këto të ardhura janë paguar këto detyrime, siç kërkon neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016; **(v)** leja e qëndrimit të huadhënësit në shtetin grek, e lëshuar në vitin 1998, përveçse tregon statusin e qëndrimit të tij në Greqi dhe regjistrimin për herë të parë në regjistrat e punësimit më datë 09.02.1998, nuk tregon dhe as provon punësimin e huadhënësit, kohën e këtij punësimi dhe as të ardhurat e siguruar prej tij.

14.5.5. Në të tilla kushte, trupi gjykues vlerëson se aktet e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, për të provuar të ardhurat e siguruar nga huadhënësi në periudhën 1992 – 2000, përveçse janë akte që nuk i përkasin huadhënësit ato në asnjë rast nuk përmbushin kriteret e provueshmërisë për t’u konsideruar si akte që dëshmojnë për burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave, në çfarëdo vlere qofshin ato. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga puna në emigracion e huadhënësit për vitet 1992 – 2000, në shumën 2.800.000 lekë, ka mbetur në nivel deklarativ, i cili duket se është ngritur me qëllim përmirësimin e analizës financiare të huadhënësit. Për këto arsye, trupi

grykues çmon se konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të huadhënësit, z. P.H., të ardhura të pretenduara si të siguruara nga puna në emigracion, në Greqi, në vitet 1992-2000, është një qëndrim i drejtë dhe i mbështetur në ligj.

14.6. Subjekti ka kontestuar edhe zërin e shpenzimeve të jetesës në analizën financiare të personit tjetër të lidhur, z. P.H., duke pretenduar se në kushtet kur familja e tij banonte në fshat, në rastin më të keq duhet të pranohet që ajo realizon të paktën aq të ardhura sa janë shpenzimet jetike, që do të thotë se analiza financiare e kësaj familje nuk duhet të ngarkohet me shpenzime jetike.

14.6.1. Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin në vlerën 0 (zero) të shpenzimeve për jetesë të familjes së personit tjetër të lidhur, trupi gjykues, siç është përmendur edhe më lart, ka konstatuar se Komisioni në analizën financiare të kryer për këtë familje ka aplikuar në zërin “shpenzime jetese”, shpenzime të reduktuara në raport me ato që ka përcaktuar INSTAT për vitet përkatëse dhe që janë aplikuar nga organet e rivlerësimit për të gjithë rastet e tjera.

14.6.2. Në funksion të analizës financiare të huadhënësit, z. P.H., për shkak të statusit si “familje bujqësore”, rezulton se Komisioni, pavarësisht se nuk ka përfshirë të ardhura nga bujqësia në analizën e tij, për shkak të mosprovimit të realizimit të tyre, ka aplikuar një reduktim të kostove të jetesës në masën 47% -50 %, të cilën e ka aplikuar edhe për familjen e subjektit. Ndërsa nën këtë frymë, për prindërit e bashkëshortit të subjektit, të gjitha kostot e jetesës janë konsideruar si të mbuluara nga të ardhurat e pensioneve të pleqërisë, edhe pse sipas të dhënave të INSTAT shpenzimet e jetesës janë më të larta se pensionet që ata rezulton të kenë marrë.

14.6.3. Në këto kushte, rezulton se edhe pse toka bujqësore në fshatin Vakuf, Dibër, me sip. 8074 m², është vlerësuar e mjaftueshme për të mbuluar jetesën e një familje bujqësore, me 6 (gjashtë) persona me banim në fshat²³, në terma financiarë nga Komisioni disponimi i kësaj toke është konsideruar i aftë të reduktojë shpenzimet e jetesës, për 3 (tre) familje me një total 13 persona, për të gjithë periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2016, pa konsideruar faktin se familja e subjektit së bashku me vjehrrin dhe vjehrrën nga vitit 2001 e në vijim nuk kanë jetuar në fshat, por në qytet, fillimisht në Peshkopi e nga vitit 2010 në Tiranë, për pasojë nuk kanë jetuar me të ardhurat nga bujqësia, por me ato të siguruara nga punësimi e pensionet. Nën këtë optikë, trupi gjykues konstaton se për shkak të disponimit të tokës bujqësore, Komisioni në analizën financiare të kryer prej tij i ka njohur/aplikuar shpenzime për kosto jetese të reduktuara, si familjes së subjektit, ashtu dhe familjes së huadhënësit, duke i lejuar, për pasojë të kenë një mundësi kursimi të konsiderueshme, e cila mbetet e diskutueshme nëse i përgjigjet realitetit dhe pse nuk vjen në harmoni me metodologjinë e përdorur deri më sot nga organet e rivlerësimit, të cilat shpenzimet e jetesës i kanë përllogaritur sipas të dhënave të INSTAT.

14.6.4. Në terma financiarë, qëndrimi i mbajtur prej Komisionit, lidhur me shpenzimet e jetesës, që afekton edhe analizën financiare të personit tjetër të lidhur, do të lexohej si vijon. Nëpërmjet reduktimit në masën 47% - 50% të kostove për shpenzime jetese të familjes së huadhënësit dhe familjes së subjektit, përfshirë edhe prindërit e bashkëshortit të saj, mbi bazën

²³ Sipas parashikimit të ligjit nr.7501/1991 dhe sasisë për frymë që parashikonte ky ligj.

e përlogaritjeve të kryera në Kolegj, konstatohet se kjo metodologji ka sjellë përmirësim të analizës financiare tyre në masën 7.114.522 lekë, për periudhën 2001 – 2010. Në këto kushte, nëse do të pranoheshin si të mirëqena të ardhurat e pretenduar prej subjektit nga tokat bujqësore në fshatin Vakuf, Dibër, si dhe nga shfrytëzimi i gjedhëve e nga bletaria, në përputhje me të dhënat mbi të ardhurat që evidenton Bashkia Dibër, ato në total do të arrinin vlerën 6.561.000 lekë. Kjo vlerë rezulton të jetë më e vogël se përfitimi që sjell në analizën financiare reduktimi i bërë nga Komisioni për kostot e jetesës për familjen e subjektit dhe huadhënësin (në raportin 7.114.522 lekë “bonus” nga reduktimi i shpenzimeve me 6.561.000 lekë që evidenton Bashkia Dibër, si e ardhur nga toka), për periudhën 2001 – 2010.

Në këto kushte, edhe në versionin që do të pranohej se ka të dhëna të besueshme që përmbushin kërkesat e organeve të rivlerësimit, për të provuar se të ardhurat nga aktiviteti bujqësor i familjes së huadhënësit kanë qenë në shumën 4.100.000 lekë, sërish përfshirja e tyre në analizë nuk do të sillte një rezultat “më pozitiv” nga ajo që ka prodhuar reduktimi i kostove të jetesës me rreth 50 %.

14.6.5. Në këtë drejtim, trupi gjykues sjell në vëmendje se: *Së pari*, nivelet e shpenzimeve për kosto të jetesës që aplikojnë për efekt të analizës financiare organet e rivlerësimit janë shpenzime kryesisht bazike, të identifikuar nga ente shtetërore të besueshme si INSTAT, i cili ndër vite ka treguar edhe metodologjinë e përlogaritjes së tyre. *Së dyti*, shpenzimet për kosto jetese të përdorura nga organet e rivlerësimit kalimtar janë kosto të aplikuar edhe më parë nga organi kompetent i ILDKPKI-së, për të kryer kontrollin ndër vite të pasurive të subjekteve deklarues, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret reduktimi i kostove të jetesës, që ka kryer ndërkohë Komisioni, jo vetëm që nxjerr analizën financiare jashtë skemës apo parametrave me të cilat është kryer ndër vite kontrolli nga ILDKPKI-ja dhe nga vetë organet e rivlerësimit në raste të tjera, por përjashton mundësinë që pretendohet nga subjekti për ta konsideruar këtë zë të analizës me vlerën 0 (zero). Për pasojë, në analizën financiare që është kryer për familjen e personit të lidhur, trupi gjykues arrin në përfundimin se reduktimi i shpenzimeve të jetesës i kryer nga Komisioni ka lejuar subjektin të ketë një analizë të arsyeshme dhe të pranueshme në kushte specifike të rastit, por ky reduktim nuk mund të shtrihet më tej, sipas një pretendimi krejtësisht subjektiv e të paargumentuar.

14.7. Në përmbledhje të sa analizuar më sipër, trupi gjykues i gjeti të pabazuara pretendimet e subjektit për përfshirjen në të ardhurat e personit tjetër të lidhur të të ardhurave nga aktiviteti bujqësor prej shfrytëzimit të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², në pronësi të tij, në fshatin Vakuf, Dibër, por edhe prej shfrytëzimit të tokës arë në të njëjtin fshat, me sipërfaqe prej 8.560 m², në bashkëpronësi të familjes së subjektit të rivlerësimit. *Së pari*, për shkak të paprovueshmërisë së krijimit të tyre në vlerat e pretenduara prej subjektit duke qenë se janë përcaktuar në mënyrë hipotetike në aktet e sjella duke u mbështetur në deklaratimet e të interesuarave. *Së dyti*, për shkak të faktit se nga analiza që Komisioni ka bërë për mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur ka reflektuar nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve të jetesës në një vlerë përafërsisht 50% në raport me ato të përcaktuara prej INSTAT-it, për shkak të të ardhurave të përfituara nga bujqësia e që kanë ndihmuar familjen e këtij shtetasi të përballojë shpenzimet për jetesë. Vlerat e reduktuara në shpenzimet e jetesës prej Komisionit,

tejkalojnë edhe ato të pasqyruara në shkresën, me nr. {***} prot., datë 30.07.2021, e Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të Bashkisë Dibër, si të realizuara prej tij. *Së treti*, vlera e pretenduar si e përfituar prej shfrytëzimit të tokës bujqësore në bashkëpronësi të familjes së subjektit, e përcaktuar në shkresën nr. {***} prot., datë 22.07.2021, të Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të Bashkisë Dibër, rezulton të jetë reflektuar në analizën financiare të vetë subjektit për vitet 2001 – 2010, edhe në këtë rast nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve të jetesës, në vlerën rreth 50% në raport me ato të INSTAT-it. Të ardhurat e tjera të pretenduara si të siguruara nga huadhënësi, që i përkasin periudhës para vitit 2000, trupi gjykues vlerëson se kanë mbetur vetëm në nivel deklarativ e, si tilla, nuk mund t'i nënshtrohen analizimit të mëtejshëm.

14.8. Në konsideratë edhe të qëndrimit të mbajtur më sipër, lidhur me reduktimin e shpenzimeve të huadhënësit me vlerën e dy investimeve të bëra prej tij për ndërtimin e objektit në Sharrë, Tiranë dhe për blerje automjeti, trupi gjykues arrin në përfundimin se konfirmohet vlera e bilancit negativ të konkluduar nga Komisioni, në masën prej 2.530.320 lekësh, e cila, në këtë rast, në vlerësimin e Kolegjit nuk lejon as konsiderimin e mundësisë potenciale për kursim të personit tjetër të lidhur, si një e ardhur që mund të llogaritet për blerjen e pasurisë. Ky vlerësim lidhet me rrethanat specifike të rastit, të cilat tregojnë se personi tjetër i lidhur nuk gëzonte një ekonomi familjare të shëndoshë e të sigurt, ai vetë detyrohej, siç deklaroi subjekti, të emigronte në periudha sezonale në shtetin grek çdo vit, për të siguruar të ardhura, me disa rrethana specifike familjare, të cilat e bëjnë të pamundur të besosh se çdo mjet monetar të fituar në emigracion për një periudhë 10-vjeçare ai e kishte kursyer dhe akumuluar, pa e përdorur për nevojat e familjes së tij e që më pas ia dha hua për një periudhë 12-vjeçare subjektit, duke i mohuar vetes dhe familjes përdorimin e të vetmes vlerë monetare që dokumentohet se është krijuar prej tij.

14.9. Për këto arsye, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë burimet e ligjshme të krijimit të huas dhe, për pasojë, edhe përdorimin e saj për krijimin e pasurisë, apartamenti banimi, në Tiranë.

15. Trupi gjykues, gjithashtu, mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë periudhës së rivlerësimit është i gabuar, dhe jo i bazuar në ligj, pasinë analizën financiare të kryer subjekti i rivlerësimit ka rezultuar gjithmonë me situatë financiare pozitive dhe se momenti i vetëm në të cilën subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme është krijimi i pasurisë apartament në Tiranë, i cili ka ardhur pasi në mënyrë të pa drejtë nuk është përfshirë si burim financimi i kësaj pasurie shuama prej 60.000 eurosh e siguruar nga huaja e marrë nga huadhënës P.H.*

15.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, është konkluduar në mënyrë përfundimtare se subjekti i rivlerësimit *ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak balancës negative në shumën 7.350.904 lekë (germa "b", e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).*

15.2. Nga zbërthimi që i bëhet kësaj balance negative rezulton se ajo përfaqëson moskonsiderimin e shumës prej 60.000 eurosh si burim krijimi të pasurisë apartament në Tiranë, për shkak se subjekti dështoi të provojë burimet e ligjshme të krijimit të huas, për pasojë edhe përdorimin e saj për krijimin e kësaj pasurisë. Siç u evidentua në arsyetimin e këtij vendimi, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me analizimin e burimeve financiare të krijimit të kësaj shume, për rrjedhojë në kushtet kur huaja në shumën 60.000 euro nuk mund të konsiderohet si burim financimi i kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit gjendet me mungesë të burimeve të ligjshme për të gjithë vlerën e huas në blerjen e apartamentit në Tiranë, në vitin 2010, në shumën 12.000.000 lekë.

15.3. Pavarësisht arsyetimit/qëndrimit të mësipërm, në funksion të një qëndrimi garantist e shterues, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kreu një analizë financiare për personin tjetër të lidhur, z. P.H., duke konsideruar si të zbritshme shpenzimet për investime, në analogji me qëndrimet e ngjashme të Kolegjit, prej së cilës rezultati financiar i kësaj analize do të mund të korrektohej vetëm në vlerën e këtyre investimeve, duke rezultuar sërish me balancë negative. Në vijim të këtij arsyetimi, duke abstraguuar logjikën e përdorur në arsyetimin e këtij vendimi, trupi gjykues vlerësoi mundësinë financiare të subjektit për krijimin e pasurisë, duke përfshirë në analizën financiare të kryer për ekonominë e saj familjare të gjithë shumën, e cila rezultonte hipotetikusht e mundur të kursehej prej personit tjetër të lidhur. Sipas këtij vlerësimi, rezultoi se sërish subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për të krijuar pasurinë apartament në Tiranë, në vitin 2010.

15.4. Sipas modifikimit që do të pësonte analiza financiare e personit tjetër të lidhur e kryer në Komision, duke përjashtuar prej saj shpenzimet për investimet e realizuara prej tij në ndërtimin në Sharrë, Tiranë, si dhe për blerjen e automjetit, do të rezultonte që ai kishte mungesë të burimeve për të krijuar shumën e dhënë hua në vlerën prej (-) 1.582.033 lekësh. Në këtë kontekst, nëse në analizë do të përfshihej si burim i ligjshëm shuma prej 6.137.668 lekësh, e cila përfaqëson mundësinë e personit të tjetër të lidhur për kursim me burime të ligjshme, atëherë pamundësia financiare e subjektit e evidentuar në vendimin e Komisionit në vlerën (-) 7.350.904 lekë do të reduktohej në shumën (-) 1.213.236 lekë, duke e vendosur sërish subjektin në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e apartamentit. Këtë diferencë, trupi gjykues e vlerësoi në raport me gabimet matematikore dhe logjike që konstatoi në analizën financiare të kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit, për periudhën 2004 –2 016, të cilat në rast se do të ishin ndrequr prej Kolegjit do të paraqisnin një situatë tjetër financiare të ekonomisë së saj, sipas logjikës në vijim. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së shërbimit Ligjor, ka konstatuar se në analizën financiare të Komisionit nuk janë përfshirë si të ardhura ato të pretenduara prej subjektit se janë realizuar nga shfrytëzimi i tokës bujqësore përgjatë këtyre viteve në vlerën 1.710.000 lekë, të deklaruara si të tilla edhe në deklaratat periodike edhe në atë *vetting*. Në rrethanat e përmendura më lart, Komisioni, duke marrë në konsideratë gjithë pretendimin e subjektit se familja e saj ka funksionuar brenda një ekonomie bujqësore, ka reduktuar shpenzimet e jetesës për këtë familje në masën 47-50% të shpenzimeve të INSTAT-it, si edhe ka konsideruar se shpenzimet e jetesës për vjehrrin dhe vjehrrën e subjektit janë mbuluar me pensionet e tyre. Ky proces analitik, i kryer prej Komisionit, ka sjellë si rezultat në terma financiarë që, ndonëse subjektit nuk i janë njohur të ardhurat në natyrë me burim nga toka bujqësore në masën 1.710.000 lekë të pretenduara prej saj, nga ana tjetër, për shkak të

bashkëpronësisë mbi tokën bujqësore, familjes së subjektit i janë reduktuar shpenzimet për kosto jetese në vlerën 7.869.478 lekë. Në këtë mënyrë, subjekti ka rezultuar, sipas Komisionit, me një balancë pozitive në periudhën 2004 – 2016.

15.5. Trupi gjykues, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, lidhur me konstatimin e saktë të situatës faktike, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, ndërtoi analizën financiare, sipas metodologjisë së zbatuar në Kolegj, duke reflektuar pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat nga bujqësia dhe aplikuar shpenzimet e jetesës për familjen e saj, sipas të dhënave të INSTAT-it. Ky version i analizës financiare do të ishte në vlerësimin e trupit gjykues analiza e saktë logjike e matematike për të përcaktuar mundësitë financiare të subjektit për përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive gjatë kësaj periudhe, përderisa subjekti nuk mund të pretendojë, që ndërsa i njihen si të ardhura ato që vijnë nga ekonomia bujqësore, të konsiderohet njëkohësisht edhe mundësia e reduktimit edhe të shpenzimeve të jetesës. Pas korrigjimit të këtyre defekteve të analizës së Komisionit, rezulton se subjekti do të ishte me një rezultat financiar të ndryshëm për vitet e marra në analizë si më poshtë:

- (i) viti 2007 (-) 50.745 lekë;
- (ii) viti 2009 (-) 71.371 lekë;
- (iii) viti 2010 (-) 1.400.151 lekë;
- (iv) viti 2012 (-) 103.161 lekë;
- (v) viti 2014 (-) 381.054 lekë;
- (vi) viti 2015 (-) 513.021 lekë;
- (vii) viti 2016 (-) 498.387 lekë.

Në total, do të kishte një balancë negative prej (-) 3.017.890 lekësh.

15.6. Balanca negative e rezultuar nga analiza më sipër në shumën (-) 1.213.236 lekë, nëse ky versioni i analizës do të ishte vendosur në themel të këtij vendimi, u vlerësua prej trupit gjykues se nuk ishte në kushtet e zbatimit të parimit të proporcionalitetit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe moszbatimin e masës disiplinore, për shkak të një metodologjie të gabuar të përdorur nga Komisioni, lidhur me reduktimin e shpenzimeve të jetesës në konsideratë të një ekonomie bujqësore ndihmëse, në më shumë se dyfish nga sa ka pretenduar edhe vetë subjekti, metodologji e cila ka deformuar rezultatin e analizës financiare të subjektit për periudhën 2010 – 2016. Nën dritën e këtij arsytimi, trupi gjykues çmoi se edhe kjo balancë e rezultuar, duke konsideruar disa nga pretendimet e subjektit, por duke pasur parasysh se nuk përfaqëson realitetin siç është arsyetuar më lart, nuk e vendosi atë në nivelin e justifikimit bindshëm të burimeve të krijimit të pasurisë apartament, në Tiranë.

15.7. Për sa u arsyetua më lart, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë në asnjë prej rrethanave e analizave të mësipërme, burimin e krijimit të pasurisë apartament në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në një nivel të tillë që e kualifikon atë sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 16.** Në vlerësim dhe analizë të qëndrimeve të mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës. Konkluzionet e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e një deklarimi të

pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke passjellë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra. Për pasojë, vendimi nr. 456, datë 08.10.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 456, datë 08.10.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 23.05.2024

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi